

Kompass EasyBusiness – Një Instrument Strategjik për Rritjen e Eksportit nga ExportAlbania.al

Si të gjeni klientë ndërkombëtarë përmes Kompass EasyBusiness

Ky udhëzues është krijuar për kompanitë shqiptare që kërkojnë të zgjerojnë rrjetin e tyre ndërkombëtar të partnerëve dhe klientëve përmes një platforme të provuar globale.

AIDA ofron akses pa kosto në një nga platformat më të avancuara B2B globale: Kompass EasyBusiness. Ky instrument i fuqishëm për gjenerimin e klientëve potencialë, analizë të tregjeve dhe gjetje partnerësh është tashmë i disponueshëm për të gjitha bizneset shqiptare të regjistruara në exportalbania.al.

Hapat:

- Regjistrohuni në exportalbania.al
- Kërkoni linkun për të hyrë në Kompass përmes panelit tuaj
- Zgjidhni vendin, sektorin dhe kriteret e filtrimit
- Përdorni kontaktet për outreach ose përgatitje për evente

Platforma Export Albania e shndërron rrjetëzimin ndërkombëtar në një proces të thjeshtë dhe efektiv përmes shërbimit Kompass. Ky nuk është thjesht një direktori biznesesh por është një mekanizëm aktiv që krijon lidhje me blerës, investitorë dhe partnerë strategjikë në mbarë botën.

Në botën e sotme dixhitale, po bëhet gjithnjë e më sfiduese të gesh mundësi të reja biznesi. Për këtë ju nevojitet një zgjidhje si Kompass që është një mekanizëm inteligjent rrjetëzimi për të lidhur bizneset shqiptare me partnerë, blerës dhe investitorë globalë.

EasyBusiness është moduli profesional i platformës Kompass, i cili ofron akses në mbi 50 milionë kompani në më shumë se 70 vende. Ai bazohet në një sistem klasifikimi të produkteve dhe shërbimeve me mbi 53,000 kode specifike, dhe ofron mundësi të gjera filtrimi dhe analizimi të kompanive dhe tregjeve duke përdorur një tipologji unike.

Sistemi identifikon automatikisht partnerë të përshtatshëm për biznesin tuaj. Ofrojmë lidhje direkte duke organizuar takime B2B online apo fizike në ekspozita ndërkombëtare, ku ju prezantoni produktet tuaja përpara blerësve nga Evropa, Azia, ose Amerika. Ofrojmë asistencë gjatë negociatave, përgatitjes së dokumentacionit dhe nënshkrimit të marrëveshjeve.

Link me 12 video bazë për përdorimin e Kompass /Online help:

<https://www.youtube.com/playlist?list=PLRoz0Ez57xtGh29TfeUye5XYepCd3819O>